

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit te kërkesës	Tarifa
1.	07.01.2021	Kompania e cila ndër të tjerash merret edhe me hulumtime në sfera të ndryshme. Ne si kompani jemi duke e bërë një analize për te cilën po na duhen disa informata rreth popullsisë në Bashkinë të Skraparit. Po na duhen informatat për numrin e banorëve nëpër fshatra për njësitë administrative; Qendër, Bogovë, Vëndreshe, Çepan, Potom, Leshnje, Gjerbës, Zhepë.	14.01.2021	Në përgjigje të shkresës tuaj me Nr. 7/1 Prot. datë 14.01.2021 po ju dërgojmë informacionin. Bashkëlidhur dhe tabela e të dhënave.	E plotë	Nuk ka
2.	14.01.2021	<p>Bazuar në Ligjin Nr.18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” si dhe Udhëzimin Nr. 262 datë, 26.05.2021 "Për miratimin e metodologjisë se punës për menaxhimin e rastit të fëmijës ne konflikt me ligjin, nga punonjësi i mbrojtjes se fëmijës" të cilin e gjeni bashkëlidhur duhet të dërgohet informacion lidhur me menaxhimin e rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin për vitin 2021.</p> <p>Përsa më sipër kërkojmë nga ana juaj, plotësimin e formularit te cilin e gjeni bashkëlidhur ku duhet te përmbajë informacion statistikor dhe narrativ lidhur me menaxhimin e rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin për vitin 2021.</p>	18.01.2021	Email Bashkëlidhur tabelën.	E plotë	Nuk ka

3.	09.04.2021	<p>Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është autoriteti përgjegjës, i pavarur, që mbikëqyr dhe monitoron zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale duke respektuar dhe garantuar njohën e publikut me informacion publik me qëllim ushtrimin e të drejtave dhe formimin e pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe shoqërisë. Në zbatim të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, Zyra e Komisionerit është e angazhuar për të gjetur mënyrat më efektive të rritjes së transparencës nga ana e autoriteteve publike. Për sa më sipër, me qëllim përditësimin e databazës së autoriteteve publike, kërkohet informacion në lidhje me institucionet tuaja të varësisë të cilat vlerësohen si autoritete publike më vete në kuptim të pikës 1 të nenit 2 të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”. Për këtë qëllim, të mbahen në konsideratë edhe ato institucione publike të cilat janë shoqëri tregtare ku shteti/njësia e vetëqeverisjes vendore zotëron shumicën e aksioneve apo çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike. Sqarojmë se institucionet që do të referohen nga ana juaj,</p>	12.04.2021	<p>Në përgjigje të shkresës tuaj me Nr.667.Prot, datë 09.04.2021, me lëndë "Kërkohet informacion për institucionet e varësisë që vlerësohen Autoritete Publike, protokolluar në institucionin tone me nr.1028, datë 12.04.2021, ju bëjmë me dije se institucionet e varësisë të Bashkisë Skrapar, të cilat cilësohen si Autoritete Publike janë si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Skrapar</li> <li>2. Ndërmarrja e Shërbimeve Pyjore Skrapar</li> <li>3. Ujësjellës-Kanalizime Sh.a Skrapar</li> </ol>	E plotë	Nuk ka
----	------------	--	------------	--	---------	--------

		do të mbulojnë vetë detyrimet e parashikuara nga Ligji për të Drejtën e Informimit. Informacioni i kërkuar duhet t'i vihet në dispozicion Zyrës së Komisionerit brenda datës 21.04.2021.				
4.	12.04.2021	Kërkesë Për Informacion të dhënat statistikor për ASHDMF për vitin 2021.	14.04.2021	Email Bashkëlidhur tabelën.	E plotë	Nuk ka
5.	26.04.2021	Kërkesë për informacion. Unë banoj jashtë shtetit dhe për kërkesën e pasaportës Italiane kam nevojë për aktin e lindje në Çorovodë mund të më thoni ku duhet të shkoj për ta kërkuar si dokument.	30.04.2021	Nr. 15/1 Prot. datë 30.04.2021 Për kërkesën tuaj për akt lindje drejtohuni në Zyrën e Gjendjes Civile Arkivi Skrapar.	E plotë	Nuk ka
6.	11.05.2021	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka në kuadër të Kalendarit të Festave Lokale JANAR - DHJETOR 2021, është duke mbledhur informacion mbi festat e realizuara nga bashkitë e qarkut Berat.  Për sa më sipër, kërkojmë nga ana juaj të na dërgoni një përshkrim të shkurtër të festave të realizuara nga ana juaj, bashke me linkun përkatës të publikuar në rrjetet sociale.  Bashkëlidhur lutem të gjeni listën me festat e propozuara dhe dërguara nga ana juaj në fillim të vitit 2021, dhe nëse keni festa të tjera të cilat i keni realizuar nuk ndodhen në kalendarin e festave ju lutem të na i dërgoni.	16.05.2021	Festat e parashikuara në kalendarin e Festave Lokale 2021, për muajin Janar janë: Festa e Ujit të Bekuar Dita e Shërbimit Pyjor Shqiptar (27 Janar) për muajin Shkurt janë: Promovimi i sporteve dimërore (20-28 Shkurt) për muajin Mars janë: Dita e Verës (14 Mars, Mat) Festë në kalanë e Dimalit Turizëm (14 Mars, Bistrovicë, Urë Vajguore) Dita e Verës dhe hapja e sezonit turistik (14 Mars, Përmet) për muajin Maj janë: Festa e Domates(Maj, Drenovicë, Kutalli) Hapja e Sezonit Turistik (10-14 Maj, Berat) për muajin Qershor janë: Kampionati	E plotë	Nuk ka

				<p>Rajonal i Raftingut (Qershor, Berat) për muajin Gusht janë: Festa e Shën Marisë (15 Gusht, Vodicë, Sinjë) Pelegrinazh në malin e Tomorrit (19-23 Gusht, Tomorr) për muajin Shtator janë: Festa e Verës (15 Shtator, Kantina Çobo, Qendër Urë) Festa e Verës (15 Shtator, Kantina Isak Vrion) Festa e Rroshnikut (Shtator, Berat) Festa e Rakisë (19 Shtator, Çorovodë) për muajin Tetor janë: Festa e vajit të ullirit (10 Tetor, Cukalat) Sofra Kuçovare (18 Tetor, Kuçovë) Panairi i Ullirit (Tetor, Bilçë) për muajin Nëntor janë: Festa e Mandarinave (15 Nëntor, Hingë, Poshnje) për muajin Dhjetor janë: “Sofra Beratase” (Dhjetor, Berat)</p>		
7.	3.08.2021	Informacion mbi zjarrin e rënë ne lagjen “5 Shtatori” ne Qytetin e Çorovodës.	05.08.2021	<p>Kthim përgjigje e-mail. Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 29 pika 1 dhe 2 dhe në ligjin nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile” neni 30 germa dh. Ju informojmë se: Në datën 02.08.2021 rreth orës 16:30 në pjesën e poshtme të lagjes “5 Shtatori” pranë disa banesave private u konstatua një vatër zjarri e cila u përhap me shpejtësi duke djegur rreth 1 hektar</p>	E plotë	Nuk ka

				me shkurre dhe pemë frutore. Ky zjarr rrezikoi disa banesa private që ndodheshin aty pranë , por ndërhyrja për shuarjen e tij ishte e shpejtë dhe në kohën e duhur. Gjatë operacionit për shuarjen e flakëve të këtij zjarri morën pjesë 11 forca të ekipit të zjarrëfikses Skrapar, punonjësit e Emergjencave Civile, banorë të lagjes aty pranë dhe disa punonjës të tjerë të Bashkisë Skrapar. Dy mjetet që ka në përdorim Bashkia Skrapar njëra Tip Man me kapacitet mbajtës 11500 litra ujë dhe tjetra me kapacitet mbajtës 4000 litra ujë vepruan deri në fund të operacionit. Operacioni për fikjen e këtij zjarri zgjati deri në orën 20:30 ku u bë e mundur izolimi i vatrës së zjarrit dhe fikja plotësisht e tij. Për shkakun e rënies së zjarrit Policia e Shtetit po bën hetimet përkatëse.		
8.	05.08.2021	Në vijim te e-mailit te dërguar ditën e sotme për situatën e krijuar nga zjarret, lutemi, plotësimin e informacionit që do të dërgohet nga sot e ne vijim me te dhëna mbi: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Zjarret aktive;</li> <li>2. Mjetet qe janë ne terren;</li> </ol>	12.08.2021	Ju njoftoj për zjarret e rënë në Bashkinë Skrapar për periudhën 05.08.2021 deri 12.08.2021 <ol style="list-style-type: none"> <li>1- Data 06.08.2021 zjarr në shkurre e ferra fshati Vërzhezh.</li> <li>2- 08.08.2021 shkurre e ferra fshati Vërzhezh.</li> </ol>	E plotë	Nuk ka

		<p>3. Personat e proceduar/arrestuar për zjarrvënie dhe për cilat raste;</p> <p>4. Problematikat me mjetet e fikjes së zjarrit (remonte, mungesa, defekte) te mjeteve duke specifikuar sipas bashkive.</p>		<p>3-09.08.2021 zjarr në Malin e Tomorrit në pyll me pish shkurre e ferra.</p> <p>4 - 09.08.2021 zjarr në mbeturinat e qytetit.</p> <p>5 - 09.08.2021 zjarr në shkurre e ferra fshati Zogas.</p> <p>6- 10.08.2021 zjarr në pyll me pisha dhe kullota Mali i Tomorrit.</p> <p>7- 10.08.2021 zjarr në pyll me lisa shkurre e ferra fshati Therepel.</p> <p>8 - 11.08.2021 zjarr në mbeturinat e qytetit Zjarr aktiv për momentin është në monitorim zjarri në Malin e Tomorrit Janë ndaluar nga policia 2 persona për zjarrvënje ne malin e Tomorrit dhe për zjarrin në Therepel Makinës MAN. Ju bë servis dhe janë në gatishmëri të plotë.</p>		
9.	12.08.2021	Informacion për zjarret gjatë periudhës 02.08.2021	18.08.2021	Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 29 pika 1 dhe 2 dhe në ligjin nr. 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile" neni 30 gërma dh. Ju informojmë se: Gjatë kësaj periudhe të vështirë që po kalojmë me situatën e zjarreve kemi disa raste në Bashkinë Skrapar. Rasti i parë në Bashkinë Skrapar ndodhur në datë 02	E plotë	Nuk ka

			<p>Gusht, ku u dogj një sipërfaqe rreth një hektar me shkurre, pemë frutore, barishte, dhe një kasolle me dru në lagje "5 Shtatori" të qytetit të Çorovodës. Në këtë rast u rrezikuan dhe shtëpitë private që ndodheshin aty pranë. Ky zjarr filloi rreth orës 16:00 dhe u fik rreth orës 20:30 të mbrëmjes, për fikjen e tij morën pjesë 2 automjete zjarrfikëse me 11 efektiv shërbimi, Emergjencat Civile, Shërbimi i Pyjores, dhe Banorë të komunitetit aty pranë. Rasti i dytë ishte në datën 04 Gusht 2021 në fshatin Zogas Njësia Administrative Qendër Bashkia Skrapar. Në këtë rast u dogj një sipërfaqe prej 2 hektarësh e përbërë kryesisht me shkurre. Ky zjarr filloi rreth orës 12:30 dhe u shua rreth orës 20:30 në operacionin për shuarjen e flakëve të tij morën pjesë 12 forca të Zjarrfikëses, Emergjencat Civile, Shërbimi Pyjor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike dhe disa Banorë. Ky zjarr u riaktivizua dhe përgjatë 3 ditëve në vijim, por u bë e mundur fikja nga ana e forcave zjarrfikëse me mjete të ndryshme rrethore pasi dhe terreni i vështirë nuk mundësonte për të çuar mjetin zjarrfikës në vend. Rasti i tretë në datën 04 Gusht në</p>		
--	--	--	---	--	--

			<p>fshatin Vëndresh e Tretë Njësia Administrative Vëndrësh u dogj një sipërfaqe rreth 5 hektar shkurre dhe pemë të ndryshme. Ky zjarr u aktivizua rreth orës 11:30 dhe zgjati deri rreth orës 18:00 kur u bë e mundur dhe shuarja e flakëve të tij. Në këtë operacion morën pjesë 6 efektiv të Zjarrfikëses, 4 punonjës të Shërbimit Pyjor, punonjës të Policisë së Shtetit dhe Banorë të komunitetit. Rasti i katërt ndodhi në datën 06 Gusht në afërsi të vendit të grumbullimit të plehrave të qytetit të Çorovodës. Në këtë rast u dogj një sipërfaqe rreth 1 hektar me shkurre, ndërhyrja ishte e shpejt në këtë rast ku u shpëtuan dhe disa ullishte që rrezikoheshin shumë. Ky zjarr filloi rreth orës 12:00 dhe u fik rreth orës 13:40 nga ana e forcave zjarrfikëse ku morën pjesë 12 efektiv 1 mjet zjarrfikës, Emergjencat Civile, Shërbimi Pyjor , Policia e Shtetit dhe Banorë të Komunitetit. Rasti i pestë ndodhi në datën 09 Gusht 2021 zjarri zonën e mbrojtur në Malin e Tomorrit në zonën mbi Teqe ku u dogj pyll me pisha. Ky zjarr fillo rreth orës 08:00 dhe u fik rreth orës 14:30, por u riaktivizua përsëri ditën tjetër dhe u</p>		
--	--	--	---	--	--



			<p>fik përsëri nga forcat zjarrfikëse. Ky zjarr dëmtoi sipërfaqe 1.5 hektar me pisha në operacionin për fikjen e tij morën pjesë 12 efektiv të forcave Zjarrfikëse, Emergjencat Civile, Punonjësit e Zonave të Mbrojtura, Shërbimi Pyjor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike dhe Banorë të komunitetit. Ky rast ka dhe një autor të identifikuar nga ana e Policisë së Shtetit. Rasti i gjashtë ndodhi në datën 10 Gusht në fshatin Therepel Njësia Administrative Vëndreshë Bashkia Skrapar. Ky zjarr filloi në zonën mbi rezervuarin e fshatit Therepel dhe era e fortë e favorizoi menjëherë dhe rrezikoi seriozisht një lagje të fshatit dhe objektin e kultit Teqenë që ndodhet aty pranë. U dogjën rreth 4 hektar pyll lisa dhe gështenja dhe pemë të tjera. Ky zjarr filloi rreth orës 13:50 dhe u fik rreth orës 21:30, morën pjesë forcat Zjarrfikëse me 6 efektiv dhe një mjet, Emergjencat Civile, Policia e Shtetit, Shërbimi Pyjor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike më një Fadromë, gjithashtu në ndihmë të këtij rasti erdhën dhe forcat e zjarrfikëses Berat me 8 efektiv dhe një mjet. Ky rast ka</p>	
--	--	--	--	--

				dhe një autor i cili u arrestua nga ana e Policisë së Shtetit.		
10.	03.09.2021	Në kuadër të një emisioni që po realizojmë, kemi nevojë për informacion nga secila bashki për projektet që ka përfituar secila bashki në kuadër të Rilindjes Urbane.	16.09.2021	Në përgjigje të shkresës suaj, datë 03.09.2021, "Kërkesë për informacion", ju informojmë si më poshtë vijon: 1. Fondi total që bashkia Skrapar ka përfituar nga Rilindja Urbane është 265 427.536 Lekë, i ndarë ky: 132.713.768 Lekë për vitin 2016 132.713.768 Lekë për vitin 2017 2. Bazuar ne Vendimin nr.1, datë 04.02.2016, të Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve, "Për përcaktimin e buxhetit e të drejtimeve prioritare të fondit për zhvillimin e rajoneve dhe kalendarit të programeve të financimit, për vitin 2016, për shpërndarjen e financimit për projekte të grantit "Infrastruktura Vendore dhe Rajonale" Programi i zhvillimit vendor dhe rajonal, Shtylla I, Thirrja I, për vitin 2016", I ndryshuar. Bashkia Skrapar ka përfituar projektin : "Rikualifikim i hapësirave përreth pallatit të Kulturës, rruga me trafik të kufizuar/pedonalja "Pasho Hysi", rruga automobilistike "Pasho Hysi",	E plotë	Nuk ka

				me vlerë 264.704.108 (Dyqind e gjashtëdhjetë e katër milion e shtatëqind e katër mijë e njëqind e tetë) Lekë me TVSH. Ky projekt ka përfunduar. 3 Kompania e cila ka zbatuar punimet për këtë projekt është bashkimi i operatorëve : "DESARET COMPANY" shpk & "ALB LEAA INTERNATIONAL" shpk. Kompania e cila ka mbikëqyrur këtë projekt është bashkimi i operatorëve "INVICTUS & C.E.C. GROUP & D.T.CON" shpk. Ky projekt është projektuar nga : "SEED Consulting & AKUA" 4.Ky projekt pasi ka përfunduar punimet pa problematika është marë në dorëzim nga bashkia.		
11.	08.11.2021	Kërkohej një punonjës përgjegjës për aplikim projekti në sistem online.	10.11.2021	Në përgjigje të shkresës me nr. 2183 prot., datë 08.11.2021, ku nga ana jonë kërkohet caktimi i një punonjësi përgjegjës për aplikim projekti në sistem online në fushën e Ujësjellës Kanalizimeve. Ju bëjmë me dije se: Sh.a. Ujësjellës Kanalizimeve Skrapar cakton në këtë detyrë punonjësin: Emër Mbiemër: Adresa e Emailit: Nr. i telefonit: Pozicioni i punës: Drejtor Teknik "U.K. sh.a Skrapar" Z. ka njohuri bazë	E plotë	Nuk ka

				kompjuterike. Jemi në pritje të njoftimit tuaj për trajnimin e këtij punonjësi për përdorimin e sistemit.		
12.	12.11.2021	<p>Në mbështetje të reformës në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizime për rritjen e performancës dhe cilësinë e shërbimit, si dhe në vijim të raportimeve nga ana juaj, kërkohet që, brenda datës 16 Nëntor 2021 të sillni në AKUM të dhënat si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1 Skemën ekzistuese të strukturës së shoqërisë (organigramën)</li> <li>2. Numrin e punonjësve të parashikuar sipas strukturës (ndarë sipas pozicioneve të punës në organigramë)</li> <li>3. Numrin faktik të punonjësve (ndarë sipas pozicioneve të punës në organigramë) Duke ju falënderuar për bashkëpunimin, ju kujtojmë respektimin e afatit të dërgimit të informacionit.</li> </ol>	15.11.2021	<p>Nr 520 Prot. 15.11.2021</p> <p>Në përgjigje të shkresës tuaj, nr.2238 Prot, datë 12.11.2021, ku nga ana juaj kërkohet skema ekzistuese e strukturës së shoqërisë, numri i punonjësve të parashikuar sipas strukturës, si dhe numri faktik punonjësve aktual. Ju informojmë se:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1- Numri i punonjësve të parashikuar sipas strukturës (ndar sipas pozicioneve të punës në organigram), është 54 (pesëdhjeta e katër) punonjës.</li> <li>2- Numri faktik i punonjësve aktual (ndarë sipas pozicioneve të punës në organigram ) është 48 (dyzet e tetë) punonjës. Bashkëlidhur me shkresën ju dërgojmë organigramën e strukturës organike të Ujësjetës Kanalizimeve sh.a Skrapar, si dhe strukturën organike të miratuar nga Këshilli i Administrimit me Vendim, nr. 04. date, 05.01.2021.</li> </ol>	E plotë	Nuk ka

13.	29.12.2021	<p>Në bazë të ligjit nr. 119/2014 për të drejtën e informimit, kërkojmë si informacion për kontratën me numrin e referencës së procedurës/lotit: REF-75539-10-14-2020</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kur kanë filluar punimet?</li> <li>2. Në sa lote janë të ndara?</li> <li>3. Sa përqindje janë kompletuar</li> <li>4. Kur supozohet të mbarojnë punimet?</li> <li>5. A ka pasur vonesa?</li> <li>6. Nëse ka vonesa, cilat janë arsyet?</li> </ol>	30.12.2021	<p>Nr 154/1 Prot data 30.01.2021 Duke ju falënderuar për interesimin tuaj, ju informojmë si më poshtë: Proceduara e prokurimit me Nr. REF-75539-10-14-2020, me objekt "Zhvillimi i atraksionit turistik mbështetur mbi potencialet lokale" është zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Në territorin e bashkisë Skrapar është duke u implementuar njëri nga nënobjektet e kësaj kontrate me emërtesë "Rijetëzimi i Qendrës Bogovë dhe rruga për në Ujëvarën e Bogovës". Bashkia Skrapar është hartuesi i projektit të mësipërm. Në cilësinë e përfituesit të këtij projekti ne kemi ndjekur nga afër ecurinë e punimeve të cilat përgjithësisht kanë ecur me ritme të mira. Në dijeninë tonë punimet janë ndërprerë për shkak të interesimit të projektit me linjën e dërgimit të ujës-jellës të qytetit të Beratit. Fondi Shqiptar i Zhvillimit në bashkëpunim me Sipërmarrësin dhe Mbikëqyrësin e punimeve kanë bërë modifikimet e nevojshme të projektit të cilat bashkia Skrapar i ka miratuar dhe presim të rifillojnë punimet. Për informacione të mëtejshme mund ti drejtoheni</p>	E plotë	Nuk ka
-----	------------	--	------------	---	---------	--------

				FonditShqiptar të Zhvillimit, si Autoritet Kontraktor.		
--	--	--	--	---	--	--